



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli i Ministrave

V E N D I M

Nr. 637, datë 19.9.2012

P Ë R

**DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.23, DATË 20.1.2010,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KRIJIMIN E AGJENCISË
KOMBËTARE BËRTHAMORE", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", dhe të ligjit nr.10 314, datë 16.9.2010, "Për ratifikimin e protokollit shtesë të marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike, për zbatimin e garancive në të gjitha veprimtaritë bërthamore të Shqipërisë", me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.23, datë 20.1.2010, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në fund të pikës 3 bëhen këto shtesa:

- “ - inspekton dhe verifikon gjendjen dhe inventarin e raportuar nga përdoruesit dhe zotëruesit e lëndëve e të materialeve, të parashikuara në protokollin shtesë dhe në vetë marrëveshjen e garancive;
- harton raportet për materialet e sipërpërmendura dhe përdorimin paqësor të energjisë dhe teknologjisë bërthamore;
- informon në vazhdimësi Agjencinë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike (IAEA) për gjithçka dhe sa herë është parashikuar në protokollin shtesë të marrëveshjes së garancive.”.

V
M/P

2. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. AKOB-ja, për të realizuar misionin dhe objektivat e saj, si dhe për plotësimin e detyrimeve institucionale, që rrjedhin nga protokollin shtesë i marrëveshjes së garancive, bashkëpunon dhe bashkërendon veprimtarinë ndërmjet institucioneve të ndryshme të vendit, publike dhe/ose private, të grupeve të interesit, vendase dhe/ose të huaja, dhe, konkretisht, me:

- Qendrën e Fizikës Bërthamore të Zbatuar;
- Komisionin e Mbrojtjes nga Rrezatimi;
- Agjencinë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike (IAEA);
- struktura të ngjashme të vendeve të ndryshme të rajonit dhe të botës;
- universitete dhe institucione kërkimore, në fushat që mbulon dhe përfshin programi kombëtar bërthamor;
- institucione jofitimprurëse e donatorë të ndryshëm, vendas dhe/ose të huaj, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;
- institucionet, publike e private, përdoruese dhe zotëruese të lëndëve e materialeve, të parashikuara në protokollin shtesë dhe në vetë marrëveshjen e garancive.”.


3. Përdoruesit e zotëruesit e lëndëve e të materialeve, të parashikuara në protokollin shtesë dhe në vetë marrëveshjen e garancive, krijojnë kushtet dhe mundësitë për inspektim dhe verifikim, sa herë që të lindë nevoja.

4. Efektet financiare përballohen nga Agjencia Kombëtare Bërthamore.

5. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Agjencia Kombëtare Bërthamore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI



SALI BERISHA

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI DHE MINISTËR
I EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS**

EDMOND HAXHINASTO